



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 1097 prot

Koplik më: 73 / 04 / 2026

V E N D I M

Nr 22 datë 22 / 04 / 2026

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e tij të datës 22.04.2026, mbeshtetur në aktin normativ nr 3 datë 15.03:2020 neni 5, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015. "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9 pika 1.7/a, të Ligjit 94/2022" PËR TITUJT E NDERIT DHE TITUJT VENDORË TË NDERIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" neni 9 pika 1.

VKM Nr.861 datë 10.12.2014 Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhënien e medaljeve dhe titujve vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë.

VENDOSI

T'i akordojë titullin "Qytetar Nderi "Znj. Dila Vaçaj me motivacionin:

"Për veprimtarinë e saj të spikatur në fushën e folklorit si artiste shumëdimensionale, si dhe për angazhimin e saj të palodhur si organizatore dhe drejtuese artistike në një sërë aktivitetesh dhe evenimentesh kulturore. Si dhe për kontributin e saj të çmuar në ruajtjen, trashëgimin dhe promovimin e vlerave të kulturës tradicionale të Malësisë, veçanërisht të veshjeve karakteristike si xhubleta, xhamadani dhe çakçirët."

1. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Brendshme.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 22.04.2026

Vota Pro 25

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 03.04.2026

